



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 31.03.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. DPKI-JWCVQQ-0235, për zyrtarin Besnik Përquku, Zyrtar i lartë për trajnime dhe zhvillim në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, për shkak se nuk ka prova që argumentojnë dyshimin për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përmes platformës raporto korrupsionin si dhe në formë fizike ka pranuar një denoncim për shqyrtim të konfliktit të interesit nga raportuesi i rastit i cili ka ngrit pretendime për shqyrtimin e konfliktit të interesit, citojmë raportimin;

Njoftim për dyshim të konfliktit të interesit dhe trajtim të pabarabartë në Trajnimin: Ndergjegjesimi.parandalimi, dhe luftimi i korrupsionit

“Me këtë shkresë, ju informoj juve si institucion kompetent Agjencinë Kundër Korrupsionit për një rast të dyshuar të konfliktit të interesit dhe për pasojat që ka shkaktuar në pjesëmarrjen time në Trajnimin Ndergjegjesimi parandalimi dhe luftimi i korrupsionit, në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. 01-.2025-05.09.2025. Gjatë këtij Trajnimi, zyrtari Besnik Përquku zyrtar për trajnime në Akademinë Kosovës për Siguri Publike, ka qenë njëkohësisht pjesëmarrës dhe koordinator i këtij trajnimi. Në këtë cilësi, ai jo vetëm që merrte pjesë si ne, në trajnim, por edhe na udhëheq neve dhe ligjëruesit, duke marrë rol menaxhues edhe pjesëmarrës në mënyrë që, sipas bindjes time, përbën konflikt interesi dhe shkelje të barazisë ndërmjet pjesëmarrësve në trajnim. Si pjesëmarrës dhe koordinator njëkohësisht, ai

ka pasur mundësi të ndikojë në organizimin, vlerësimin dhe rrjedhshmërinë në tërë procesin, duke përfshirë rezultatet që lidhen me performancën e tij.

Detyrat e tij gjatë trajnimit ishin: Koordinator i trajnimit: ka përgatitur orarin, ka menaxhuar procesin dhe na kontrolluar gjatë aktiviteteteve; Ka qenë në listë si pjesëmarrës dhe ka vijuar trajnimin, ju kemi nënshtruar testit ka hyre në test në fund të trajnimit shih rezultatit e ti dhe në fund është qertifikuar sikur të gjithë pjesëmarrsit por me një përqindje në test të lart vetëm her her ka marr pjesë një or dy por ka figure pjesëmarrës i rregullt. Vlerësues i trenimit: ka dhënë vlerësime mbi mënyrën e zhvillimit të trajnimit e ka vlerësuar vetveten në formular i cili plotësohet në fund të trajnimit nga pjesëmarrësit. Unë personalisht e edhe të tjerët jemi ndjerë të trajtuar jo i barabartë dhe nën ndikim të vendimeve të tij gjatë trajnimit. Ky rol i dyfishtë i tij ka ndikuar negativisht në cilësinë dhe paanshmërinë e trajnimit. Bazuar në këto rrethana, dyshoj se caktimi i tij në këtë rol është bërë në kundërshtim me procedurat ligjore dhe kërkoj nga Agjencia që të shqyrtojë rastin, të verifikojë ligjshmërinë e këtij vendimi dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit pas pranimit të raportimit ka filluar procedurën e shqyrtimit të pretendimeve të ngritura për konflikt interesi.

Me qëllim të sqarimit të pretendimit të ngritur Agjencia ka kërkuar dhe pranuar dokumentacionin relevant nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të pranuar është konstatuar gjendja faktike si në vijim;

Zyrtari Besnik Përçuku, e ushtron funksionin zyrtar i lartë për trajnime dhe zhvillim në kuadër të divizionit për trajnime të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Trajnimi “Ndërgjegjësimi, Parandalimi dhe Luftimi i Korrupsionit” ishte pjesë e planit të trajnimeve për vitin 2025 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Zyrtari Besnik Përçuku, ishte pjesëmarrës në trajnimin “Ndërgjegjësimi, Parandalimi dhe Luftimi i Korrupsionit” dhe ka marrë certifikat për vijueshmëri të trajnimit.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike në përgjigjen e ofruar për Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit ka sqaruar se citojmë; Udhëheqësi i Divizionit të Trajnimit në AKSP me rastin e organizimit të trajnimeve nga ana jonë cakton koordinatoren e atij trajnimit vetëm për mbarëvajtjen sa më efikas të tij.

Në nenin 9 paragrafi 1, nenin 19 paragrafi 2 dhe nenin 24 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2012 për Trajnime dhe Zhvillim të Karrierës në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, shprehimisht thuhet;

- 1. Planifikimi i trajnimit dhe zhvillimi i materialeve (trajnim i ri, ndryshim trajnimit, mësim i ri, ndryshim mësimi, etj), bëhet në bashkëpunim të Trajnuesit/mësimdhënësit dhe DTZHK-së, kurse standardizimi i materialit, formatizimi, dizajnimi bëhet nga DTZHK-ja.*
- 2. Zyrtari i testimeve në bashkëpunim me ligjeruesin e materialit trajnues të institucioneve përkatëse bënë zhvillimin, përpilimin, implementimin e të gjitha testeve për të gjitha trajnimet/kurset që mbahen në kuadër të AKSP-së.*



3. *Kontrollimi testeve bëhet në Zyrën e Testimit, kopja origjinale e rezultateve të testit dorëzohet në DAKPS.*

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas shqyrtimit të pretendimit për konflikt interesi, dokumentacioni të pranuar sipas detyrës zyrtare, vlerëson se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kjo për faktin se konflikti i interesit lidhet me përfshirjen e zyrtarit në vendimarrje, në të cilën ka interes privat për vete apo personat e afërm që ndikon, mund të ndikoj apo duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri të detyrës zyrtare.

Fakti se Besnik Përquku është caktuar koordinator për trajnimin “Ndërgjegjësimi, Parandalimi dhe Luftimi i Korrupsionit” nuk përbën situatë të konfliktit të interesit.

Pas shqyrtimit të gjendjes faktike dhe pretendimeve ankimore është konstatuar se zyrtari nuk është përfshi në vendimarrje apo në qastet paraprake të vendimarrjes me elemente thelbësore dhe përcaktuese për rezultatin final siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi 1.12 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në të cilën thuhet se;

1.12. Vendimarrje – çasti i fundit i procesit vendimarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.

II Agjencia vendosi duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: palët e pakënaqura kanë të drejtë të inicojnë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit